



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **18.03.2020**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes nënkryetarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Para të fillojmë mbledhjen, jemi në një situatë e cila është krijuar jo edhe e mirë dhe urojmë që sa më shpejt të dalim prej kësaj gjendje.

Të nderuar anëtare të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Planit lokal për veprim në Mjedis për vitin 2019-2024,**
3. **Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për Eficiencë 2019-2020,**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje të interesit të përgjithshëm parcela Nr.P-71510068-01713-5 në zonën kadastrale në Ratkoc,**
5. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale në fshatin Radoste,**
6. **Raport i menaxhimit të aseteve komunale (inventari) për vitin 2019,**
7. **Informatë e listës së pronave komunale dhe menaxhimi i tyre,**
8. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – E vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar** – A ka dikush diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditë.

2. **Shqyrtimi i Planit lokal për veprim në Mjedis për vitin 2019-2024.**

Bjondina Rama – Përshëndetje për të gjithë, unë dua në pika të shkurta me shku në bazë të raportit përfundimtar të ekipit të ekspertëve për zbatimin e projektit **Plani lokal për veprim në Mjedis për vitin 2019-2024**, pra në vitin 2019 e ka të shënuar vitin pasi kemi pasur disa kërkesa apo vërejtje për arsye se ka filluar në atë periudhë dhe nuk mundem me ndryshuar. Pra në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës 01/361 2019 u formua grupi punues për zbatimin e këtij projekti.

Plani lokal i veprimit në Mjedis është obligim ligjor kur del prej ligjit për mbrojtje të Mjedisit prej nenit 32. Fillimisht është bërë një plan dinamik i aktiviteteve dhe pastaj ka filluar në zbatimin e njëjtë në terrene duke filluar hulumtimin dhe shqyrtimin e të gjitha dokumenteve zyrtare, raporteve dhe burimeve të tjera të lidhura me Mjedisin. Gjithashtu edhe ekipi ka shqyrtuar gjithë legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar që lidhet me fushën e Mjedisit. Që nga fillimi i këtij projekti ekipi dhe koordinatori komunal kanë organizuar takime me organizata që merren me menaxhimin e ujerave të zeza, mbeturinave me qellim të informatave dhe objektivave për grumbullimin e të dhënave sa më të nevojshme dhe sa më të bollshme sa i përket planit lokal të veprimit në Mjedis. Unë mendoj se ky plan është pothuajse i ligjshëm pasi u përfshi në të gjitha materialet që ne i kemi për momentin, por ne në të ardhmen mundemi me i shqyrtuar gjëra të reja që kemi, i inkorporojmë, i rregullojmë pra nuk do të thotë që do të jetë kështu siç është. Sa i përket të gjitha formave, ky është mbajtur edhe debati publik edhe gjithë zyrtarët kanë qenë të pranishëm edhe në webfaqe ka qenë i

shpallur, po ashtu edhe çdo drejtorive ju kemi dërguar planin që aty ku ka vërejtje që me i rregulluar. Unë e kam marr procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit dhe e kam parë që të shëndetësia ka pasur vërejtje, ju kam dorëzuar raportin drejtorisë së shëndetësisë dhe i kanë përmirësuar aty ku kanë menduar që nuk janë të rregulluara mirë sepse ka pasur vërejtje edhe prej asambleistëve sepse nuk do të thotë vetëm prej asambleistëve që i kemi këtu prezentë. Mendoj që është një plan kompleks që i ka disa të dhëna që Komuna e Rahovecit më herët nuk i ka pasur, mundem me thënë që ka vlera që duhet me i shqyrtuar dhe duhet realizuar pra mundem me thënë që në përgjithësi në pika të përgjithshme është i shënuar mirë në bazë të metodologjisë dhe procedurave nuk mundem me i ikë. Sa i përket ajrit, te ajri nuk ka të dhëna pothuajse asnjë komunë, në përgjithësi matja bëhet në Prishtinë se instituti nuk ka matës, kjo pjesë e ajrit do të rregullohet në të ardhmen nëse marrim ndonjë matës të ajrit apo e rregullojmë këtë çështje. Materialin e keni përpara dhe për të gjitha vërejtjet e juaja, ne këtu jemi. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit e nderuar, gjithsesi materialin të gjithë e kemi përpara dhe materiali i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore. Unë deshta të ndalem pak tek objektet e mbrojtura të propozuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ne mbledhjen e parë kemi bërë një propozime që e kemi një çeshmë në fshatin Celinë që të futet si zonë e mbrojtur pra çeshmja e fshatit aty ku është të cilën nuk e pashë që ndoshta me siguri drejtoresha e ka planifikuar edhe këtë. Ndoshta është mirë me theksue edhe në faqen 38 tek sistemi i ujitjes që deri me tani komuna jonë ka qenë vetëm fshati Pastasel pa sistem të ujit dhe tani edhe ky vendbanim nga data 12 e këtij muaji ka kyqjen e ujit në sistemin e Radoniqit që ndoshta është mirë edhe atë futë si fshat edhe ata do të bëjnë kyqjen. A ka dikush ndonjë vërejtje sa i përket kësaj pike.

Bjondina Ramaj – Sa i përket çeshmes në Celinë, ne nuk mundemi me shënua për arsye se zonat e mbrojtura kanë kushte pasi duhet nga agjencioni të bëhet kërkesa dhe të dërgohet në agjencion dhe pastaj më cek. Nuk mundemi ne si komunë me vendosë atë vend si zonë të mbrojtur pra njëherë duhet me bo kërkesën në agjencion në mënyrë që ata me aprovua dhe pastaj ne me vendosë. Sa i përket KRU-Gjakoves, ne i kemi marr të dhënat prej tyre drejtpërdrejtë edhe Pastaseli që me datën 12 të këtij muaji që u shënua pra duhet të shohim procedurat e rrjedhjes se qysh po shkojnë edhe e vendosim normal bashkërisht me pëlqimin e atyre dhe e shënojmë edhe aty. Faleminderit

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, këshilltarë kolegë, drejtorat, mediat dhe gjithë që janë prezentë në këtë sallë. Unë e kam lexuar me kujdes Planin Lokal të Veprimt për Mjedis për vitin 2019-2024. E përgëzoj ekipën e cila ka punuar që sigurisht është bërë një punë mjaft e madhe, është gjithëpërfshirëse. Zyrtarja që e prezantoj e ceku se ne kemi pasur disa vërejtje në të kaluarën pasi e kemi pasur këtë plan edhe njëherë në shqyrtim shkurtazi para se të qitet në debat publik, unë i kam pasur disa vërejtje në shëndetësi edhe pikërisht tek drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike. Disa përmisime janë bërë mirëpo unë mendoj që nuk janë bërë aq sa janë dashtë kështu që është përsëri ai shqetësimi im që këtu ka disa gjëra edhe nga koha e kaluar do të thotë kur ka fillua me u punua me herët kanë mbete ashtu dhe nuk është punuar sa duhet tash në gjendjen çfarë është kështu që i gjithë dokumenti ka disa gjëra që nuk përkojnë me momentin me të cilin jemi sepse gjërat kanë ndryshuar. Janë përfshirë ato tri shtyllat kryesore që është bazuar ky plan edhe mendoj që janë shumë në rregull do të thotë analiza e gjendjes mjedisore që është e domosdoshme janë të dhënat aty, lista e problemeve mjedisore do të thotë janë identifikuar problemet sigurisht të ambientit ku ne jetojmë edhe plani i veprimt të zgjidhen ato probleme pasi ne jemi të vetëdijshëm se problemet gjithmonë dalin me kohë mirëpo ato duhet të zgjidhen. Edhe këtu është punuar mirëpo megjithatë mendoj se nëse ky plan çalon diku pra çalon edhe aty, edhe te pjesa analiza e gjendjes mjedisore, përshkrimi i gjendjes momentale ka disa vërejtje, unë do ti paraqes ato, thash edhe me herët se diçka është përmirësuar nga ajo që kam përmendur me herët mirëpo përsëri duhet me intervenua në mënyrë që deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, nëse ka mundësi drejtoritë përkatëse me i bo ato ndryshime sepse mendojmë që dokumenti sa me realisht që i prezanton gjendjen e ambientit tone do të jetë më mirë, në mënyrë që më vonë me mbetë sa ma pak me u punua në ato ndryshime që do të paraqiten edhe pse jam i vetëdijshëm se ndryshimet kanë me u paraqitë me kalimin e kohës sigurisht edhe me siguri se do të punohet në atë drejtim që ato të zgjidhen në mënyrë adekuate. Dua të bëj ndërhyrje për hir të sqarimit në faqe 20, arsimi dhe institucionet arsimore që janë disa të dhëna këtu që cekën në fillim të faqes p.sh. numri i mësimdhënësve janë 710 kurse numri i nxënësve gjithsej është 14 526 edhe raporti nxënës mësimdhënës 20.4, mua po më intereson se a është kjo gjendje edhe tash sepse unë e

kam dëgjuar edhe drejtorin komunal të arsimit i cili e ka cekë një shifër tjetër e cila është më e vogël tash, siç duket këto shifra janë të para 4-5 viteve që dallojnë shumë. Pastaj te çerdhet ceket se është një çerdhe publike, janë 6 çerdhe parashkollore private, a qëndron kjo kështu përsëri këto çerdhe private pasi unë nuk kam dëgjuar që kaq shumë çerdhe pra po dua me thanë që le të shikohet mirë nga secila drejtori në mënyrë që të dalin të dhënat sakta që janë në raporte me situatën në terrene apo raporti nxënës mësimdhënës 22 deri 42, a qëndron kjo ende apo mos ka ndryshuar pra kjo ishte sa i përket arsimit që me i pas disa sqarime. Në shëndetësi faqe 22, përsëri duhet me pas ndërhyrje, mendoj që prezantimi duhet të jetë shume i saktë p.sh. te qendra kryesore e mjekësisë familjare QKMF „Fahredin Hoti, Rahovec thotë ofron shërbime shëndetësore të nivelit primar pjesërisht edhe shërbime sekondare. Unë mendoj që duhet të ceket ajo konsultativë pasi nuk janë sekondare deri në fund po ashtu ceket një renditje jo bash e qëlluar p.sh. sekondare pediatri, interno, gjinekologji, maternitet stomatologji, imunizim pra stomatologjia edhe imunizimi i takojn primares e jo sekondares do të thotë një radhitje që ka nevojë të shikohet që në radhitje të mos gabohet. Po ashtu e kemi QMF në Ratkoc, Drenoc, Fortesë dhe Çifllak ofrojnë këto shërbime si atë primar imunizim ndërkaq në dy ambulanca shëndetësorë e që në fakt i kemi 7 ambulanca shëndetësore pra duhet me ndërhy aty pastaj e dimë që Ratkoci edhe Krusha e Madhe e kanë shërbimet e njëjta, aty ka edhe laboratorë kurse që punohet ne dy ndërrime është cekur. Tek Kultura, Rinia dhe Sporti edhe atëherë kam pasur kërkesë që të bëhen përmirësime, këto janë të dhëna që i takojnë të kaluarës pasi këtu ka objekte që është menduar në mbrojtje e që nuk ekzistojnë tani, pra është shërbye kjo drejtori me një listë që nuk është e tanishme pasi i takon të kaluarës pra ka edhe shume objekte që mendoj që duhet të futen në liste për trashëgimi kulturore dhe historike pasi nuk janë të përfshira p.sh. ceket këtu xhamia e qershisë në Rahovec. Ne Rahovec i kemi disa xhamia dhe unë personalisht mendoj se nëse është ndonjë xhami e cila duhet të futet në mbrojtje duhet të jetë xhamia e Kasumajve që është tek sheshi i Republikës që është me e vjetra dhe që ka një arkitekture të vjetër dhe që ka një histori që unë tani s'mundem me thanë këtu sepse është histori e gjatë por mendoj që duhet të mendohet për të gjitha xhamitë, për teqet, disa kroje nuk janë përfshije pra janë disa objekte që unë e kam përmendur edhe me përpara urën e Files,qytetin antik Sejana që ka atje gjurmë dhe që duhet të hulumtohet, po mendoj që megjithatë se a do të mbetet kjo me u punua për të ardhmen dhe a do të mundet kjo drejtori brenda kësaj kohë me i bo këto ndryshime nuk e di por sidoqoftë këto vërejtje ne përsëri do ti kemi e ndoshta ti punojmë me vonë pra nuk është kryer sa duhet. Pastaj disa sqarime tek emërtimet, nëse thuhet beteja e Fortesës ose shtabi i UÇK-së në Reti, duhet të ceket se çka është ajo, shtëpi, lapidar pasi nuk ceket këtu d.m.th. ta ketë kuptimin e plotë. Faleminderit

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë e falënderoj zyrtaren që na ka sjellë Planin Lokal për Veprim në Mjedis për komunën e Rahovecit. Të them të drejtën këtu janë përshkruar shumë gjëra por jo bash të gjitha, por të gjitha resurset që gjinden në komunën e Rahovecit janë të paraqitura në njëfarë mënyre, unë do të i ceki 2 apo 3 çështje pastaj vazhdojmë. Këtu thuhet dikun se ne komunën e Rahovecit e përmendi edhe zyrtarja se nuk ka pika monitoruese për të treguar cilësinë e ajrit. Unë deshta me pyet se sa kanë insistua institucionet komunale te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinorë përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës që edhe ne territorin e komunës se Rahovecit të ketë pika monitoruese të cilësisë se ajrit, thjesht deshta me pyet se a ka pasur kërkesa dhe cila ka qenë përgjigja e organeve kompetente për këtë çështje. Pastaj kur është te resurset ujore, komuna e Rahovecit ka rezerva të kufizuara thuhet të burimeve ujore, ato pak burime që janë edhe ato janë të rrezikuara nga shkarkimet e ujërave të zeza sanitare dhe industriale. Sa është bërë që këto pak burime të mbrohen nga ndotja prej ujërave të zeza dhe ujërave në përgjithësi. Po ashtu kur bëhet fjalë këtu poshtë njëfarë kontradikte më duket se teksti është i pa harmonizuar, ku në njërin anë thuhet ka rezerva të kufizuara të burimeve ujore ndërsa në anën tjetër thuhet se komuna e Rahovecit është e pasur me burime natyrore dhe ka rrjet hidrografik relativisht të dendur d.m.th. është mirë me dit se a ka apo nuk ka pra me harmonizua tekstin në mënyrë që kur ta miratojmë në kuvend me qenë tamam qysh duhet. Te trajtimi i ujërave të ndotura në komunën e Rahovecit pothuajse është në pikën zero përjashtoj impiantin në Kramovik që është, te gjitha rrjedhat e ujërave të zeza shkarkohen të pa trajtuara në ato pak burime ujore që i kemi në përgjithësi ose trupat ujore që po e quajnë këta, unë dua të di se çka ka ka planifikuar komuna e Rahovecit në Planin Lokal për Veprim në Mjedis për trajtimin e ujërave të zeza, aka plan konkret për trajtimin e këtyre ujërave të zeza edhe në fillim e ceka se janë përshkruara të gjitha resurset që i kemi mirëpo në qoftese ndalemi në titullin e saj Plani lokal për Veprim në Mjedis unë mendoj se me

shumë ka përshkrime edhe tregojmë se çka ka komuna e Rahovecit e me pak ka plan të veprimit këtu sa unë kam mundur me vërejte dhe kam lexuar mirëpo unë do të kontribuoj me tepër në mbledhje të Kuvendit me siguri d.m.th. unë atë çka kam mundur me pa që nuk e kemi çasje konkrete pasi nuk është me rëndësi për 1 apo 10 vjet apo për çfarë periudhe dhe për atë quhet edhe plan i veprimit pra çka konkretisht komuna e Rahovecit në vitet në vijim ka planifikuar ta ndryshoj qoftë ajrin, ujin, ujërat e zeza apo edhe shumë gjëra tjera prandaj po them më së paku materiali në përgjithësi lidhet me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis pasi që unë i kam lexuar këto faqet e fundit mirëpo në fakt prapë nuk shpjegon kurrëgjë, nuk ka diçka konkrete se çka do të bëjë apo çka do të ndërmerë komuna e Rahovecit dhe une mendoj se ndoshta në këtë plan është mirë me bo pak ndryshime duke u bazuar që edhe mjetet i kemi të kufizuara pasi shumë çështje nuk mundemi me i rregullua vet pasi jemi të varur prej donacioneve tjera ose prej qeverisë, konkretisht nëse marrim ujërat e zeza ne duhet ta kemi një impiant e atë vet nuk mundemi me ndërtuar dhe jam shumë korrekt në këtë drejtim mirëpo se paku në plan duhet me qenë se kur mendojmë apo kur do të ja nisim kësaj punë konkretisht.

Faleminderit

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Shumëçka u tha edhe unë plotësisht pajtohem me parafolësit për të gjitha vërejtjet që i dhanë se ky material është voluminoz edhe është si lloj përshkrimi i pasurisë që ka komuna e Rahovecit edhe të them të vërteten unë kam qenë skeptik se do të mbahet sot kjo edhe nuk jam shumë i përgatitur për këtë mirëpo i kam vetëm disa vërejtje që ndoshta nuk janë shume parimore sa janë të domosdoshme për me u theksua. E para punë është këtu e kemi në pikën 3, te objektivat specifike të Planit kur thotë transparencën për pjesëmarrjen e publikut në vendimarrjen mjedisore d.m.th. në shtetet demokratike kjo ka shume rëndësi d.m.th. mendimi dhe idetë e publikut apo të komunitetit prej veprimeve që ndodhin ose që duhet të ndodhin në komunë. E para punë siç e thash se kjo nuk është në materie por është praktikë që duhet të përdoret p.sh. në Malësi të Vogël është mbajtur një lloj referendumit për ndërrimin e emrit të fshatit dhe kemi disa fshatra që i kanë ndërrua emrat dhe unë shoh këtu se është një laramani e këtyre pasi here përdoret me emrin e vjetër e here me emrin e ri por unë mendoj se nëse populli ka bërë referendumin edhe unë e di sepse unë kam qenë pjesë e kuvendit kur ka ardh prej Prishtinës se kthehen emrat në gjendjen e mëparshme të viteve 56-ta, por e rëndësishme është që kjo duhet të potencohet p.sh. në Malsi të vogël ose Fortesë, në të gjitha përshkrimet që e bëjnë neper materiale shkruhet Malsi e Vogël (Radoste) pra të jetë i pranueshëm edhe për egon e ndërkombëtareve edhe për neve që kemi bërë një lloj referendumit. U nisa në këtë pikën e 3 sepse kjo transparenca dhe mendimi i qytetarit është edhe kjo pra nder të tjera është të mos përdoren shume emërtime por të përdoret emërtimi tjetër me kllapa pra kjo është e para që duhet të merret parasysh. E dyta e kam te menaxhimi i mbeturinave dhe ndotja e ambientit, aty përveç shumë ndotësve është edhe një ndotës te cilin nuk e theksua aty pra është ndotësi i madhe i kalljes se mbeturinave dhe gomave e materialeve plastike dhe asnjëherë nuk merr masa askush për këtë veprim që me gjet fajtorin se kush e bën d.m.th. ne shohim përditë që kallen mbeturinat, kallen gomat e ndryshme dhe shume materiale plastike që e ndotin ambientin me të madhe prandaj unë mendoj që edhe këtë duhet me shtie aty sepse është njeri prej ndotësve shumë i rëndësishëm. Nder te tjera mendoj që ka një shpërputhje e gjendjes faktike në statistika d.m.th. nuk i kemi ata banorë, nuk i kemi ata nxënës d.m.th. është një shpërputhje për të cilat mendoj se ndoshta është mirë me u konsultua edhe kur të vjen në mbledhjen e ardhshme, këto gjëra të jenë ma precize sidomos të nxënësit pasi duhet kemi një statistike, në veç kemi pasur një statistike që na ka sjellë drejtori por është krejt tjetër pastaj e kemi te përdorimi i ujit të pijshëm për banorë, unë nuk mendoj që është ajo sasi e ujit që përdoret sepse përdoret me shume dhe po ashtu ka shkarkim të ujërave të zeza me shume se sa përshkruhet prandaj është emergjente menaxhimi i ujërave të zeza edhe duhet të na tregoj menaxhmenti i Komunës siç tha edhe parafolësi se a ka ndonjë veprim që do të ndodhë sepse ujërat e zeza janë një prej faktorëve shume te rëndësishëm për shëndetin publik. Po ashtu ka edhe gabime ortografike p.sh. e kemi ne faqen 20 arsimi dhe institucionet arsimore ku nuk shkruhet prodhuar sepse prodhimi është prodhim, sipas statistikave të arsimit 2015/06 e qe duhet të jetë 2015/2016 të publikuara e jo të prodhuara sepse prodhimi është prodhim e të tjera edhe unë nuk dua me zgjat siç ju thash edhe ne fillim por duhet të kemi parasysh që të dalin sa me preciz sa i takon këtyre statistikave edhe në përgjithësi materiali. Po ashtu ne faqe 41 shqyrtuar nëse mund të replikohet, një projekt i tillë duhet shqyrtuar nëse mund të replikohet. Faleminderit

Bjondina Ramaj – Faleminderit shumë, më vjen mirë që e keni lexuar dhe keni mundësi me dhanë vërejtjet. Po fillojmë vërejtjeve drejtshkimore pasi është një dokument voluminoz edhe nuk mundet çdo fjalë të shikohet por edhe permisohet por ka mundësi me pas edhe gabime. Sa i përket dëshirës juaj të madhe që keni me vendos të dhëna është shumë e vërtetë por çdo drejtori e ka pas raportin por edhe kisha kërkuar nga ju si asamblistë nëse keni vërejtje me i dhanë me shkrim e jo me than ka vërejtje edhe kur po ju dërgojmë ata vet po i shkruan ashtu sepse skan çka me shënua pra nëse ke argument duhet me argumentua e jo veç me than ka qitu edhe mos me tregua ku. Sa i përket arsimit numri i nxënësve, ai e ka marr si numër të përgjithshëm qysh duhet me qenë në bazë të formulave dhe ligjeve që i kemi prezentë, nuk do të thotë që në komunë të Rahovecit janë 40 nxënës por në fillim shënohen sa munden me qenë edhe në bazë të formulës edhe sa janë, këtë drejtorja e arsimit e ka edhe nëse ka vërejtje apët ja dërgojmë edhe i permisojmë. Sa i përket dëshirave për xhamia apo zona të mbrojtura, është një ligj për zona të mbrojtura, nuk mundem ne me ndryshua me qit edhe pse kemi dëshirë gjithë kjo pjesë me qenë e mbrojtur por nuk mundemi me shënua derisa nuk janë të aprovuara në agjencion ose në Ministri të Mjedisit. Sa i përket shëndetësisë drejtorja e shëndetësisë e ka pasur dhe nëse ata nuk i kanë të dhënat e veta dhe nuk i dinë, këtë as unë nuk mundem me ditë sigurisht edhe ai i firmës që ja ka punua pra kur nuk din komuna ose nuk din përgjegjësit cilat janë të dhënat. Pra ka gabime që lidhen me primare dhe sekondare sepse edhe vet nuk e din mire se cilat janë primare edhe sekondare dhe duhet me u sqarua. Dhe nëse me te vërtet drejtorja nuk i ka të njohura atëherë duhet me ja dërgua edhe me ju tregua se çka janë primare shëndetësore sepse janë mundua në të gjitha mënyrat mirëpo nuk e kanë gjetur formulën e përgjithshme se si duhet me u shënua. Sa i përket trajtimit të ujërave të zeza pra ky trajtim i ujërave të zeza është në gjithë Kosovën dhe nuk është vetëm tek ne, eke që e jona është se ne kemi punua shumë ne kanalizime edhe i kemi dërgua të gjitha në Dri të Bardhe. Me herët ka qenë me lehtë sepse gropat septike i kanë pasur neper shpija edhe nuk janë shkarkua të gjitha në Dri. Unë mendoj se kjo çështje është edhe në menaxhim të Ministrisë pa pasur mjete nuk kryhet kjo, atë punë që ka pasur komuna me krye kanalizimet të gjitha i ka krye, trajtimi është shume i kushtueshëm dhe e ne e dim që ka ndotje mirëpo mundemi me permisue ne si Komunë sepse kërkon buxhet shumë të madhë duke pas parasysh gjendjen me të cilën jemi. Sa i përket ajrit se a ka matës, ne dimë se është Obiliqi që nuk ka ende matës edhe pse Rahoveci nuk njihet si një vend shumë i zhvilluar që me pas ndotje të madhe përveç kohës se dimrit nga përdorimi i thëngjillit e gjërave tjera edhe po ashtu mundem me thanë Rahoveci sa i përket Mjedisit ma shum ka ndotje nga pesticidet që prodhohen në bujqësi me shume se sa në këto në aspektet industriale që shume njerëz e marrin se ndotja e ajrit apo diçka tjetër. Ne do të rishikojmë edhe është mirë çdo kush që jep vërejtje me argumentua dhe jo veç me than se kemi vërejtje edhe kemi dëshirë këtë apo atë pasi nuk mundemi me i shënua as zonat e mbrojtura pa e pasur me ligje dhe me rregullore sepse ne shume kemi dëshirë mirëpo ndryshe është situata. Na kemi me permisue edhe besoj që aty ku kemi vërejtje, unë kam marr shënime dhe do të ju dërgojmë drejtorive por edhe ju nëse mundeni me na ndihmua do ishte mirë në emalin tim zyrtar apo të drejtorisë që i përkas me na dërgua që më pastaj ne i inkorporojmë pasi kjo është në të mirën e Komunës dhe nuk është vetëm për ne. Faleminderit

Nenkryetari - Faleminderit i nderuari kryesues, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, drejtorë të drejtorive dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Këto që i thamë sot pos Dervish Çadrakut që nuk i ka lexua me arsye, as pikën e as presjen nuk ja hekë pasi nuk është detyrë edhe obligim e asamblistëve e ne këtë rast anëtareve të Komitetit për Politike dhe Financa me ti dhanë me shkrim ty e askujt tjetër por ai vërejtje, sugjerime edhe sekretaria i regjistron ato në procesverbal edhe pastaj përgjegjësit që janë i inkorporojnë në këtë material. Për zonat e mbrojtura me ligj që përmendi edhe doktori me ligj janë të precizuara se cilat janë ndërsa të propozuara nga drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport si kjo p.sh. xhamia e Qershisë nuk ekziston fare dhe këtë të gjithë e dinë pasi është e rrënuar pas luftës por janë edhe disa objekte tjera që duhet me u inkorporua pra te futen në këtë planë lokal të veprimtimit pra ka edhe shume të tjera por siç duket grupi punues nuk i dinë. Për impiantet definitivisht pajtohem por e ceku edhe vërejtjen edhe arsyetimin se pse ndodh kjo asamblisti Rasim Fazliu. Pastaj u përmend edhe vendbanimet me emra te vjetra edhe me te rejtën që janë mbajtur edhe me refenrendum, ato janë të përcaktuara me ligjin për kufijtë administrativ dhe derisa ky ligj nuk pëson ndryshime, ne mundemi me i qit emrat e rinjë që i kemi vendos pas luftës mirëpo sipas ligjit për kufijtë administrativ janë të cekur me të vjetrën, pasi ne i kemi edhe qytetet e emërtuara p.sh. Kamenica apo Dardana, Obiliqi apo Kastrioti, Suhareka apo Therenda pra ende nuk i kemi në letër, në po

kemi dëshirë mirëpo njëherë është ashtu. Nuk do të zgjatem më tepër të gjitha këto që janë cekur këtu, le të regjistrohen ne procesverbal, ju dërgohet drejtorëve edhe çdo kush e ka për obligim me i inkorporua në këtë material. Unë dua t'i falënderoj asamblistët në këtë rast për vërejtjet, arsyet, sugjerimet pra të gjitha këto në mënyrë që ky plan të del sa ma mirë sepse nuk është planë individual por është plan komunal i të gjithëve. Faleminderit

Dervish Çadraku – i nderuari kryesues, dua të përmisoj veten time se nuk thash që nuk e kam lexuar mirëpo se e kisha se nuk e kam lexuar me vëmendje sepse kam menduar se nuk do të mbahet mbledhja sepse sikur mos të kisha lexua nuk kisha për të folur asgjë sa i përket këtyre çështjeve edhe kështu e kam lexuar në mënyra sipërfaqësore. Tek çështja e emrave, unë e di që nuk kemi të drejtë me i përdor zyrtarisht me shtetet tjera por vetëm kërkoj se neve duhet të na shpërndalet materiali me dy emra pra Malsi e Vogel (Radoste), ose e kemi të shkruar Fortesë aty edhe vjen një qytetar edhe nuk e din se ku është Ballacerka pra duhet të shkruhet në dy emrat dhe përgjegjësia duhet të jetë e atyre që ja sjellin materialin asaj kështu është mirë me u shënua këto korrekt. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit të gjithëve, atëherë pasi nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë 2019-2020.

Perparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa, te nderuar kolegë të pranishëm. Megjithëse kemi zyrtarin që merret me planin e menaxhimit të eficiencës të energjisë mirëpo në mungesë ë tij do të flas unë sa i përket kësaj pike. Këtë plan ne kemi një marrëveshje me GIZ-in gjerman që janë një grup punues prej 10 personave nga Komuna e Rahovecit që në bashkëpunim me Gizin gjerman janë duke hartuar këtë plan, i kemi ndjekur të gjitha procedurat po ashtu ka kaluar edhe ne diskutim publik dhe tani ka ardhë momenti me diskutua edhe këtu në Komitetin për Politike dhe Financa dhe të merret vendimi në Kuvendin e Komunës. Unë shkurtimisht do të ju tregoj për shkak se është një material voluminoz, Komuna e Rahovecit posedon 127 objekte administrative duke përfshirë edhe ndriçimin publik që llogaritet brenda këtij programi, objekte shkollore ka 41, objekte shëndetësore 16, objekte administrative duke përfshirë edhe administratë, kulturë, bujqësi, zjarrfikses 2, po ashtu ndriçim publik llogariten afërsisht 50 rrugë, të gjitha objektet janë në pronësi të komunës dhe në bashkëpunim me GIZ-in gjerman ne i kemi vendos një program pra një data bazë në kompjuterët e zyrtareve që i kemi në drejtori dhe në atë program hinë të gjitha të dhënat për këto objekte administrative. Janë të shënuara të gjitha vlerat, shpenzimet e rrymës, materialet që i posedojnë objektet pra janë edhe rekomandimet se si do të ndodhë brenda 2 apo 3 viteve pra çfarë plane apo veprime do të ndërmer komuna e Rahovecit në bashkëpunim me asociacionin kosovar për energji të ripërtëritshme rreth veprimeve që do të ndërmerren brenda 2-3 viteve për me trajtua me prioritet shpenzimet e energjisë. Shkurtimisht ftoj që për planin e eficiencës nëse ka dikush diçka të shtojë, në do të jemi këtu dhe do të mundohemi të japim përgjigje apo sqarime sa i përket rreth këtij plani. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a ka dikush diçka rreth pikës së tretë të rendit të ditës, atëherë nëse jo, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e trete e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje të interesit të përgjithshëm të parcelës Nr.P-71510068-01713-5 në zonën kadastrale në Ratkoc.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtare të KPF-së, para jush keni materialin propozim vendim për shpallje me interes të përgjithshëm për një parcelë private e cila gjendet ne zonën kadastrale në Ratkoc, bëhet fjalë për rrugën Xerxe-Ratkoc, kjo parcelë është marrë prej shtetit, kjo sipërfaqe private pas viteve 90-ta kur kjo rrugë është asfaltuar, asnjëherë pronari i kësaj parcele nuk është kompensuar pra kjo parcelë nuk i është shpronësua të njëjtit, pronari i njëjti i kësaj parcele kufizohet me pronë shtetërore i cili në sipërfaqe afërsisht të njëjtë, neve na figuron edhe si uzurpatorë pasi ka edhe ndërtim në kufij me pronë shtetërore. Kemi pranua kërkesë prej këtij pronari për këmbim të kësaj parcele pasi që veç që ka me shume se 30 vitë që kjo parcele i është marrë dhe sot atje faktikisht është rrugë, pasi ne kemi dashtë me rregullua këtë problem edhe me heqë prej listës se uzurpatorit këtë person por edhe edhe rregullua që rrugën ta bëjmë rrugë ndërsa pronën tashme të shfrytëzuar prej pronarit privat që është pronë shtetërore ta bëjmë pronë private.

Kërkoje nga ju që pas shqyrtimit të aprovohet propozim vendimi për shpalljen me interes të përgjithshme fillimisht e pastaj në muajin tjetër për këmbim të pronës.

Rasim Fazliu – Unë e falënderoj drejtorin për këtë paraqitje të kësaj pike të rendit të ditës por kisha propozua që për mbledhje të kuvendit në këtë material të jetë edhe skica e terrenit në zonën kadastrale të Ratkocit edhe të jetë po ashtu edhe kopja e planit për mbledhje të kuvendit edhe pse drejtori na paraqiti mirëpo se paku edhe në material të jetë që ta kenë kuvendarët parasysh saktësisht vendin se ku është, përndryshe jemi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të kësaj parcele. Ju faleminderit

Fehmi Cena – Deshta të jem me i qartë rreth kësaj që po kërkohet nga ne është propozimi shpallja e interesit të përgjithshëm publik i kësaj parcele dhe pastaj sigurisht vjen edhe kompensimi i asaj pjese pra kjo punë qenka kryer me herët pasi i është marr dikujt pronë private për rrugë që është ndërtuar dhe nuk është kompensuar. Këtu dikun ceket se materialit ja bashkëngjishim provat përcjellëse nuk kemi prova përcjellëse se a është kompensuar apo nuk është kompensuar. Pra drejtorja duhet me qenë e saktë nëse vërtet nuk është kompensuar ajo është diçka tjetër, ne kemi raste që janë kompensuar mirëpo nuk ka dokumente dhe thuhet që nuk janë kompensua. Po ashtu me intereson me dit, kjo rrugë a është rrugë regjionale Xerxe- Kramovik apo rrugë lokale, pasi tash edhe te kompensimi p.sh. ndoshta titullari do të jetë dikush tjetër tek regjionale dikush tjetër i takon me kompozua ndërsa tek lokale besoj që i takon komunës. Unë mendoj që juristet besoj që do të thonë fjalën e tyre edhe pse në mbledhjen e ardhshme ata janë prezentë dhe janë kompetentë me shumë për me fol, sidoqoftë mua kjo po me intereson e para se çfarë është kjo rrugë, lokale apo regjionale dhe po ashtu edhe provat përcjellëse që kanë cekur ata se ne i kemi se nuk jemi kompensua dhe unë nuk i kam pae këto megjithatë. Faleminderit

Afrim Oruqi – Fillimisht kërkojmë falje pasi dokumentacioni nuk është komplet edhe pse ka skicë tereni edhe kopje plani të kësaj parcele, sa i përket pyetjes se anëtarit të KPF-së, kjo është rrugë regjionale pjesën tjetër të përgjigjes e merr me shkrim në fazën tjetër ose në kuvend ndërsa sa i përket asaj se a është kompensua, unë dua të ju them se ajo nuk është kompensua dhe ju e keni para vetes fletën poseduese dhe sikur të ishte kompensuar pronari privat kjo do të kishte shkruar pronë shtetërore dhe jo private. Pra sikur të ishte kompensuar ky pronari privat sot ku është asfalti figuron në emër të dy bashkëpronareve Hoti, atëherë shteti kur e ke kompensua ose kur e ka shpronësua apo këmbje, këtë pronë e kish bërë pronë shtetërore K.K. Rahovec rrugën dhe neve po na figuron ende edhe sot e kësaj dite se kjo nuk është kompensuar dhe ky është dokument bazë që nuk është kompensuar asnjëherë. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë pasi nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e katërt rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale në fshatin Radoste (Malësi e Vogël).

Fillimisht dua të ju kërkoj falje se në mënyre elektronike e keni marr edhe vendimin për këtë pikë mirëpo gjate printimit kur e ka bo administrata, e kanë bërë edhe vendimin edhe të pikës katërt dhe ne sot ju kemi sjellë vendimin për këtë pikë pra të pikës se pestë. Po ashtu edhe për këtë pikë ftoj drejtorin e Gjeodezisë,

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, behet fjalë për zonën kadastrale në Radoste, kemi pranuar një kërkesë prej kryetarit të këshillit të fshatit dhe kryesisë se fshatit që kanë kërkuar prej neve një sipërfaqe fillimisht prej 12 ari, parcela është me shume se 1 hektar dhe saktësisht është te komuniteti RAE pra skaj rrugës dhe ata kanë kërkuar fillimisht 12 ari mirëpo për shkak të pjesëve tjera përcjellëse pse ka rrugë të kalueshme dhe ashtu edhe një trafo megjithatë ne kemi dalë ne teren dhe kemi incizuar dhe nuk kemi mundur me sigurua me shume se 7.69m2. Qëllimi i këtij vendimi është që të merret kjo sipërfaqe prej pjesës se përgjithshme dhe të i jepet në shfrytëzim kryesisë se fshatit Radoste për ndërtimin e një objekti i cili do të i shërbej për aktivitete kulturore që kanë për qëllim interesin e përgjithshëm në nivele fshati d.m.th. arsyeja është mbrojtja e kësaj parcele edhe pse aty disa pronare të komunitetit RAE kanë fillua me u zgjerua në dëme të kësaj parcele, në ato punë teknike i kryejmë por kërkojmë prej juve që të marrim vendim që të ipen për 99 vite në shfrytëzim pa kompenzim fshatit, ne fletë poseduese na figuron pronë shtetërore KK Rahovec 99 vite kryesisë së fshatit Radoste. Faleminderit

Dervish Çadaraku – Kjo pjese e tokës që është në Malësi të Vogël pra është 7.69 m2 siç e theksuat edhe ju edhe unë mendoj se është pak e vogël ajo por është mirë me u angazhua edhe komuna në bashkëpunim me KEK un pasi është një trafo aty edhe me largua nga aty dhe do lëshohet hapësirë e mjaftueshme për me

funksionue si duhet ky objekt aty sepse autoriteti i komunës është me i madhe në raport me këshillin e fshatit. Mendoj që me intervenimin ose bashkëpunimin e komunës në këtë drejtim, besoj që kish me qenë shumë më mirë për një zgjidhje adekuate për këtë objekte.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, ju në fillim posa e thatë që unë pata marr shënimet që propozimi është bërë lëshim prej pikës e katërt është qitë edhe ne pikën e pestë edhe e kam cekur se këtu duhet të ceket se është fjala për odën e fshatit që donë me ndërtua, kështu që jemi për këtë propozim edhe e kalojmë për kuvend edhe atje marrim vendim. Faleminderit

Fehmi Cena – Me kërkesën që ka bërë këshilli i fshatit aty ceket oda e fshatit dhe për qëllimet e fshatareve, kurse këtu te pika 3 ne propozim nga drejtorja pra nga kryetari do të thotë qëllimi është kulturor, tradicional pra që mbahen manifestime dhe nëse vërtet kjo e ka rëndësinë mbajtjen e manifestimeve të ndryshme dhe me gjerë tradicionale kulturore e te tjera a nuk do të ishte me mire këtu me qenë që ta shohim edhe qëndrimin e drejtorisë për kulturë rini dhe sport dhe kjo me shkua pak edhe ne mënyrë institucionale sepse disi po i shmanget institucionit dhe po kërkohet diçka që është me rëndësi që duhet të ketë implikim institucioni. Por nëse është diçka e thjeshtë odë atëherë le të ceket se për çka është ajo odë, pasi neper fshatra ka oda mjaft dhe nuk e kam të qartë se pse i duhet Radostes (Malësisë së Vogël) edhe ndonjë odë zyrtare me pas, kjo është për mua pak si paarsyeshme pasi institucioni duhet të kyqet pra drejtorja për kulture rini dhe sporte është dashtë të kyqet dhe me dhanë një mendim të vetin dhe atëherë ne do ta kishim pakës me te qartë si delegatë të kuvendit se çka po kërkohet, përndryshe duke qenë se është pak si e paqartë për mua, unë mendoj se këtu duhet të jetë një pasues sikurse ne disa dokumente e tjera që thuhet se komuna ka drejtë me rikthye përsëri atë pjesë në bazë të interesave të saj i duhet pra janë disa dokumente që i kemi pasur përpara kur i kemi dhënë në shfrytëzim pronën shtetërore edhe ne afat të shkurtër edhe në afat të mesëm, këtu nuk e shoh dhe nëse ne e japim njëherë, ajo mund të shkoj për 99 vite edhe komuna ndoshta nuk ka të drejtë me ndërhyje .Faleminderit

Nenkryetari – Faleminderit kryesues, kjo odë e fshatit i mban të gjitha aktivitetet, edhe kryetari bashke me kryesinë e fshatit i ka përcaktua edhe çdo aktivitet që është në interesin e atyre banoreve të atij lokaliteti pra edhe nëse mbahen këto aktivitete kulturore kurrëgjë të keqe nuk ka edhe nuk i anashkalon drejtorin e kulturës d.m.th. këtu përfshihen rastet e vdekjeve, dasmave munden me qenë sepse ka oda të tilla në Drenoc, Senoc ndoshta edhe në ndonjë vendbanim tjetër që nuk e di por një punë shume e mirë do të bëhet për arsye se i shkarkon shtëpitë private për të gjitha aktivitetet që mund të ndodhin edhe aktiviteti mbahet në odë të fshatit, nuk e di a do të jetë me lagje sipas fiseve p.sh. në Drenoc e ka lagja e Berishëve që ndoshta edhe të tjerët e shfrytëzojnë por kryesisht ata d.m.th. për të gjitha aktivitetet dhe nuk i anashkalon drejtorin e kulturës në asnjë mënyrë por që a mundet komuna pastaj me participue në ndërtim te saja ajo do të jetë krejt diçka tjetër.

Fehmi Cena – Një sqarim pasi në në material nuk e kishim edhe një faqe dhe na mungonte atë që kërkova unë pasi veç faqen e parë na keni sjellë edhe materialin. Kjo faqe e dytë që tash unë e mora draft vendimi këtu qenka ky pasuesi do të thotë komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kurdo herë që sipas nevojës për realizimin e interesave publike të komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës se dhënë në shfrytëzim. Atëherë ne për mbledhjen kuvendit, do të duhet ta kemi edhe këtë faqe edhe është faji i juaj që nuk na keni sjellë.

Kryesuesi – Faleminderit shumë për të gjitha, atëherë konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6.Raport i menaxhimit të asetëve komunale (inventari) për vitin 2019.

Artan Asllani – Përsëendetje për të gjithë, më propozimin e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm drejtuar kryetarit të Komunës se Rahovecit z.Smajl Latifi janë formuar komisione që kanë të bëjnë me regjistrimin e asetëve. Fillimisht kemi formuar komisionin për regjistrimin e pasurisë jo financiare, komisionin për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme me toka, tokave në komunë të Rahovecit, komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare, komisionin për tjetërsimin e pasurive, komisionin për asgjësimin e pasurive. Të gjitha komisionet që janë formuar kanë kryer punën me kohë duke filluar nga procesi i regjistrimit e asetëve dhe pasurisë se komunës se Rahovecit nën vlerën 1000 euro dhe mbi vlerën 1000 euro. Pas përfundimit të regjistrimit të inventarizimit, komisioni i formuar nga ana e kryetarit ka vazhduar me vlerësimin e tokave të komunave të Rahovecit për shkak se gjatë vitit 2018-të nuk kemi mundur me i krye të gjitha vlerësimet e tokave ndërsa gjatë vitit 2019 komisioni ka arritur të bën regjistrimin dhe vlerësimin 1127

pronave komunale. Në fund të vitit komisioni ka kryer edhe inventarizimin e pasurisë jo financiare në administratë, në arsim, QKMF dhe objekte tjera përcjellëse të komunës së Rahovecit. Po ashtu në jemi përkujdesur të bëjmë këto edhe në formë tabelare, në tabelën e parë janë regjistrimi dhe përshkrimi i punëve që janë kryer gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2019. Regjistrimi mbi vlerën 1000 euro janë 233 artikuj që janë bërë dhe vlera e tyre aseteve është 5 139 623 euro, regjistrimi më pak se 1000 euro janë 1185 artikuj dhe vlera e tyre është 105 046 euro. Ndërsa një punë e mirë mund të them që ka bërë komisioni për regjistrimin e tokave që gjithsej kanë qenë 1127 prona dhe vlera e këtyre pronave është 44 769 902 euro. Në total për vitin 2019 regjistrimi i të gjitha pasurisë të komunës së Rahovecit e kapë shifrën 50 014 572 euro. Ndërsa të përshkrimi i detyrave mbi vlerën 1000 euro, pajisjet teknologjike, informative, artikuj gjithsej kanë qenë 1865 artikuj dhe vlera e këtyre artikujve kapë vlerën 114 174 euro. Pasi e keni materialin përpara, unë dua të i them të gjitha në detaje ndërsa në tabelën e tretë është përshkrimi i të gjitha pasurisë kapitale dhe pasuritë e komunës së Rahovecit që është prej vitit 2000 deri në vitin 2019. Pra është kryer një punë e mirë pasi nuk kemi rekomandim të auditorit të jashtëm për 2018 për inventarizimin të aseteve të komunës së Rahovecit po ashtu edhe për këtë vit shpresoj se nuk do të ketë ndonjë rekomandim që kemi pasur për regjistrimin dhe vlersimin e tokave të Komunës së Rahovecit. Faleminderit

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për këtë prezantim që bëri rreth kësaj pike. Këtu dikun po shkruan se në fund të vitit komisioni ka kryer inventarizimin e pasurive jo financiare në administratë, arsim, QKMF dhe objekte përcjellëse, ku në raportin përfundimtar të tyre ka konstatuar që janë gjithsej 812 asete jashtë përdorimit. Ndoshta ka qenë mirë me na dhanë sqarime se pse janë këto jashtë përdorimit, a janë të prishura apo çka është puna tyre pra vetëm një sqarim me na dhanë edhe a janë të regjistruara të gjitha këto për gjitha këto që u thanë apo ka mundësi që me pas asete tjera të paregjistruara. Faleminderit

Fehmi Cena – Edhe unë kam vetëm një pyetje ku thuhet në këtë raport se është bërë vlerësimi i mbi 1127 pronave komunale. Pyetja ime është se a janë kryer dhe a është bërë vlerësimi i të gjitha pronave komunale apo ende ka prona të pavlerësuara edhe duhet të punohet në të ardhmen. Faleminderit

Artan Asllani – Në pyetjen e parë që u parashtrua, i gjithë inventarizimi është obligim ligjor që çdo fundvit të bëhet një përshkrim kur ka gjësende tjera që duhet të largohen. Unë mundem me thanë që në disa shkolla pas ndërhyrjeve që janë bërë në renovimin e atyre shkollave pasi janë kon të prishura karriket, tabelat apo diçka tjetër, ne e bëjmë një komision edhe del në vend të ngjarjes edhe e bën verifikimin e tyre pra ne i kemi bërë në shkollën në Drenoc, Krushe dhe me një shkollë tjetër në Rahovec pasi drejtorët e shkollave i kanë larguar ato mirëpo ne nuk kemi të drejtë me ju vendos vlerat. Këtë vit e kemi formuar një komision që e bën verifikim e tyre edhe njëherë edhe e qet vlerën e tyre se a janë për me i qitë në ankande apo apo për ti humbur. Besoj që komisioni në dy shkolla veç ka dalë në vend ngjarje edhe shume shpejt edhe ato nëse janë për me dal në ankand atëherë do ti qesim që kryesisht janë klarrika, dyer, dritare që janë duke rinovuar. Ndërsa të pyetja tjetër që parashtror doktori vlerësimi i të gjitha pronave të komunës së Rahovecit ka përfunduar në vitin 2019 ndërsa këto që janë me vlerën mbi 1000 euro janë zyrtarët ata që merren, nëse ka blerje që vazhdimisht i qesin në sistem. Në vitin 2019 janë vlerësuar 1127 prona dhe vlera e tyre është afërsisht 40 milion euro ndërsa e gjithë prona në komunën e Rahovecit komplet është 75 milion dhe ne për herë të parë në vitin 2018 dhe 2019 e kemi bërë vlerësimin e tokave. Të gjitha tokat pra pasuritë e komunës së Rahovecit janë të vlerësuara.

Fehmi Cena – Unë mendoj që në këtë raport edhe pse është për vitin 2019, mirë do ishte të kishte një pasues që për mbledhjen e ardhshme të kuvendit që me cekë ju edhe sa është numri i përgjithshëm i pronave, ju e keni vlerësuar që për vitin 2019 është ky numër ndërsa po ashtu të ceket edhe numri i përgjithshëm që ne me ditë edhe të ceket se është përfunduar ajo punë për të gjitha pronat. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, atëherë pasi nuk ka tjerë të lajmëruar kalon për Kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Informatë e listës së pronave komunale dhe menaxhimi i tyre.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtare të KPF-së, para jush e keni një dokument i cili sqaron sipas zonave kadastrale në lidhje me pronat komunale që i menaxhon kuvendi komunal i Rahovecit, behët fjalë për prona shtetërore komunale që janë në komunën tonë që i menaxhojmë ne. Unë veç do të i përmendi që i kemi shkollat, shkollat profesionale, çerdhet, objektet kultore, palestra sportive, QKMF-të,

objektet komunale dhe krejt këto bashkë të këtyre pronave që i kemi ndërtua objektet në këto prona janë 7 hektar e 2.84m² pastaj kemi për çdo zonë kadastrale për Rahovec, Brestoc, Hoçë të Vogël pra në këto zona në këto fshatra që kemi pronë shtetërore dhe sa sipërfaqe i kemi. Këtu përjashtohen pronat që janë në menaxhimin e agjencioneve shtetërore siç janë agjencioni pyjor i Kosovës, pastaj përjashtohen pronat që janë në menaxhim të AKP-së qofshin ato që janë në menaxhim apo që janë dhënë me qera e që janë nëpër këto zona ndërsa të gjitha këto bashkë sa i përket zonave kadastrale bëjnë 1191 hektar 90 ari e 75m². Faleminderit

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, jemi në gjendje të jashtëzakonshme, e falënderojmë drejtorin për paraqitjen e këtyre të dhënave në këtë pikë të rendit të ditës, unë nuk dyshoj që ka edhe objekte tjera që kanë mundur të paraqiten d.m.th. janë të gjitha komplet por unë deshta me pyet kështu te zona kadastrale këtu a është definitive kjo liste e pronave komunale, a mund të ketë prona tjera komunale që nuk janë paraqitur në këtë informate dhe është mirë me na dhanë informacione se kush i menaxhon këto prona komunale d.m.th. përgjithësi të gjitha këto fshatra dhe në qytete për me ditë se çfarë toke janë këto, a janë batallina që thuhet në gjuhen popullore, a janë të shfrytëzuara prej dikujt për me ditë, nëse ka mundësi tash mirë nëse jo atëherë për mbledhje të kuvendit është mirë me na dhanë këto sqarime sepse unë po nisem prej vendit nga vijë se ka disa parcela që janë prona komunale në komasacion por që dikush i shfrytëzon ato toka pra për këto është mirë me na dhanë informacione shtesë. Faleminderit

Afrim Oruqi – Këto të dhëna janë nxjerrë prej një sistemi i cili thirret SIKTK, ky sistem menaxhohet prej Agjencionit Kadastral të Kosovës, në këtë sistem përditësohen të dhëna çdo ditë pasi është agjencion shtetëror, këto të dhëna janë të sakta. Në këtë tabelë të parë ku i kemi vendos shkollat, kemi menduar që në të gjitha parcelat ku janë shkollat në krejt komunën e Rahovecit, kjo sipërfaqe është 4 hektar 35 ari 50m² d.m.th. në Rahovec, Kaznik dhe në Krushë të Madhe, kështu i kemi menduar edhe për shkollat profesionale edhe për çerdhe edhe për ambulantë. Ndërsa sa i përket zonave tjera kadastrale këto shifra pra këto sipërfaqe janë të sakta pasi janë nxjerrë para disa ditë prej sistemit, këto menaxhohen prej komunës së Rahovecit, më këto prona me këto zona ku ka ndërtim fizik, na kemi një listë prej uzurpatorëve që është mbi 230 persona pasi ka aktvendime për këto prona të uzurpuara ndërsa parcelat që janë pa ndërtim janë kufij me prona private, qytetaret i punojnë i shfrytëzojnë mirëpo këto janë në menaxhim të komunës. Në po kujdesemi që aty ku mundemi, po i detyrojmë ata me kërkua prej bujqësisë që ne me i dhanë me qira se paku me inkasua të holla, përndryshe ka që veç ne Celinë kemi sipërfaqe që menaxhohet prej komunës së Rahovecit që janë 53 hektar 95 ari 27m² pra këto menaxhohen direkt prej kuvendit komunal të Rahovecit. Ne kemi shumë pak kontrata me njerëz atje që i kanë marrë në shfrytëzim por ka dikush që i punon po ashtu ka edhe lëndë pa di që mendojnë ju takon toka për shkak se i shfrytëzon mbi 20 vjet kjo kryesisht me kërkesën e avokateve kjo bëhet në prona ku dihet titullari nuk fitohet prona për shkak këto prona nuk fitohet me parashtresë. Këto prona fitohen në qoftë se nuk dihet pronari dhe i ke shfrytëzua edhe nuk të ka pengua kërkush por edhe avokatet duhet kapak punë me pas, sigurisht që ka frikë në këtë muhabet, por ti mundesh me shfrytëzua 500 vjet por kurrë pronar i saj nuk bahesh, ti mundesh edhe me fitua gjykatën tonë por ka edhe gjykata e apelit pastaj supremja që sigurisht që kurrë pronar nuk bahesh, pra pronar të shfrytëzimit kanë mirëpo pronar të tokës kurrë nuk bahesh. Faleminderit

Rasim Fazliu – Unë mendoj që është një dallim me thënë se kush është pronar edhe tjetër sen është me i shfrytëzua d.m.th. pronar unë e di se është komuna e Rahovecit e atyre tokave p.sh. ne e kemi rrafshin e Malit që i themi por ato janë lëndina dhe nuk shfrytëzohen kurrëgjë por ka edhe parcela tjera që janë në rrafsh që sigurisht që i shfrytëzon dikush ato por po flas për lëndina si në Krushe të Madhe apo edhe dikun tjetër që nuk shfrytëzohen kurrëgjë e që normalisht pronar është komuna e Rahovecit por nuk janë të shfrytëzueshme kurrëgjë njëherë për njëherë janë djerrina. Faleminderit

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, falënderoj drejtorin për këtë prezantim të listës se pronave komunale, unë deshta për shëndetësi diçka nga drejtori me kërkua me na qartësua do të thotë ne bazë të saj të gjitha institucionet shëndetësore kanë pronë komunale 7 hektar e 5 ari 35m². Pyetja ime është se a janë përfshirë të gjitha pronat në të gjitha këto institucione shëndetësore, mos ka mbetur edhe ndonjë në institucionet e pa përfshie. Deshta me kërkua sqarim nga drejtori për QMF-në në Rahovec se kur është filluar me u ndërtua objekti i i ri QKMF-së, ne disa kemi propozua që objekti me u ndërtua në pjesën veriore aty ku janë ato pishat, baraka apo ish OSBE-jaku ka qenë e vendosur dhe dikush ka thënë se ajo pjesë është kontestuese pra dikush e ka kontestuar nga privatet pra nuk nuk dihet a është pronë e QKMF-së pra pronë komunale apo

private. Unë kërkoj nga drejtori me na sqarua ajo pjesë a është komunale dhe a është e evidentuar këtu apo ka mbetur ende e kontestume dhe pse. Faleminderit

Afrim Oruqi – Tek objekti i QKMF-se kemi të bëjmë me 7 hektar 58 ari 7m2 d.m.th. janë të gjitha pikat d.m.th. ambulancet kudo që janë nëpër komunë të Rahovecit është sipërfaqe e tyre dhe në fletë poseduese na shkruan pronë shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, shfrytëzues Drejtorja e Shëndetësisë. Edhe parcela që pyeti doktori është pronë shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, arsyeja pse nuk është lejuar me u ndërtua objekti i emergjencës në atë pjesë ku janë barakat ku shfrytëzohet prej ambulantes, prej ish pushtetit ju ka marr familjeve Kadiri pasi shin tri parcela, prej tyre 2 parcela u është marr pa shpronësim dhe te dy pronaret e këtyre parcelave i kanë nxjerrë pronat e veta edhe ka mbetur një parcelë, pretendimi i palës ku ka qenë e vendosur OSBE-ja. Për neve si shtete, ajo pronë është e komunës dhe është në këtë sipërfaqe të QKMF, pala pretenduese ka pasur një procese gjyqësore dhe e ka humbur kontestin, e ka vazhdua në gjykatë të apelit edhe aty e ka humbë dhe ka bërë ankesë revizion pra ka shkua në gjykatë supreme. Për derisa është në proces, në s'kemi guxuar që kjo të ndërtohet në atë sipërfaqe sepse mundet gjykata supreme me vendos ndryshe dhe neve na mbete krejt objekti në pronë private pra veç për këtë arsye, përndryshe ne jemi pronar për momentin derisa po flasim, deri në vendimin e gjykatës supreme. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Të ndryshme - Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa rreth kësaj pike, unë isha ndalë të mbledhja e radhës të cilën zakonisht e mbajmë në fund të muajit edhe e dimë që e kemi një vendim nga qeveria për takimet deri me datën 27 të këtij muaji edhe pasi ne përbejmë një grupe pak me te madhe se 10-të vet për mbledhje të Kuvendit edhe ne jemi në kontakt me MAPL-në që presim edhe rekomandimet e tyre, gjithsesi me datën 27 nuk do të mundemi me mbajte mbledhjen por do të i shohim mundësit që me datën 30 apo 31 edhe pse në këto data i kemi përvjetorët në Opterushe dhe Pastasel mirëpo edhe për këto aktivitete janë marr vendime që mos me u mbajte atëherë unë do të jem në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë juve kolegët se si do të vendosim, por urojmë që kjo situatë të mos përshkallëzohet edhe me tepër mirëpo me disa informacione që kam presidenti ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës të shpallet gjendje e jashtëzakonshme atëherë edhe nuk do të mundemi me mbajte por nëse ka ndonjë formë tjetër atëherë duke pasur edhe rekomandimet nga larte do të shohim nëse krijohen mundësit për me mbajte mbledhjen atëherë është mirë çështjen e distancave pasi këtu kemi hapësirë fatmirësisht por do të shohim si do të jen mundësitë. Gjithsesi unë do të jem në kontakt të vazhdueshëm me rrjedhën se si do të veprojmë dhe nëse nuk mundemi me mbërri që 7 ditë me herët materialin me ju dërgua asamblistëve atëherë do të kërkojmë mirëkuptimin e juaj dhe do të bëjmë përpjekje bile 3 apo 4 ditë me ju dërgua materialin nëse e mbajmë mbledhjen duke llogaritur datat 30 apo 31 pasi për datën 27 nuk kemi mundësi assesi. Faleminderit shumë për kontributin, shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi,


Agim Hoti

